

UDHËZIM
Nr. 7, datë 22.7.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN E KRITEREVE TË
KONKURRIMIT PUBLIK PËR TRANSFERIMIN E MENAXHIMIT TË
INFRASTRUKTURËS SË PESHKIMIT TE ORGANIZATAT E PESHKIMIT, NJËSITË E
VETËQEVERISJES VENDORE DHE SUBJEKTET PRIVATE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 6, shkronja “d”, të kreut II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 22.5.2019 “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private”,

UDHËZOJ:

1. Procedura për transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit, tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private, zhvillohen nga ministria përgjegjëse për peshkimin, në bazë të vendimit nr. 347, datë 22.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private”.

2. Ministria i kërkon Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës përgatitjen e dokumentacionit për dhënien me qira, enfiteozë ose në menaxhim të infrastrukturës së peshkimit, sipas përcaktimeve të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 347, datë 22.5.2019, të Këshillit të Ministrave, përveç pikës “b”, e cila përgatitet nga drejtoria përgjegjëse për programet në fushën e peshkimit.

3. Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira/enfiteozë të infrastrukturës së lidhur me peshkimin (shkallët e riparimit), janë:

a) Niveli i investimit:

Investim në kuptim të këtij kriteri do të konsiderohet vlera monetare e parashikuar në plan biznes për realizimin e projektit.

b) Niveli i punësimit:

Do të konsiderohet numri total i të punësuarve gjatë periudhës së zbatimit të kontratës së qirasë ose enfiteozës. Për efekt konkurrimi do të merret për bazë numri minimal i deklaruar nga subjekti ofertues, për çdo vit kalendarik.

c) Oferta e detyrimit mujor të qirasë:

Do të konsiderohet pagesa mujore që do të kryhet nga qiramarrësi ose enfiteozmarrësi në përmbushje të detyrimeve kontraktore.

4. Në rastet kur infrastruktura e lidhur me peshkimin (shkallët e riparimit) jepet me qira ose me enfiteozë dhe ka më shumë se një ofertë të vlefshme, për vlerësimin e ofertuesit fitues, vlerësimi do të bëhet në zbatim të metodologjisë së vlerësimit, si më poshtë vijon:

- Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve dhe metodologjisë së vlerësimit dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues, që ka numër më të lartë të pikëve, në bazë të kriterëve të vlerësimit.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i krijuar në zbatim të urdhrit të ministrit, sipas pikës 2, të kreut II, të VKM-së nr. 347, datë 22.5.2019, do të vlerësojë ofertat, duke u bazuar:

a) në kriteret e përcaktuara në pikën 9, të kreut I të VKM-së nr. 347, datë 22.5.2019;

b) pikët e shpallura në konkurrim (pikët do të variojnë dhe përcaktohen në bazë të rëndësisë që do t'i akordohet një kriteri të caktuar në urdhrin e ministrit në varësi të procedurës konkurruese rast pas rasti), duke vlerësuar ofertën më të favorshme me pikët maksimale të kriterit.

- Ofertuesi tjetër do të përfitojë pikët, duke u bazuar në aplikimin e formulës së mëposhtme:

$$P_{of} = \frac{O_{of}}{O_{max}} \times P_k$$

Pas përcaktimit të pikëve të vlerësimit për secilin kriter bëhet përlogaritja totale e pikëve si më poshtë:

$$P_t = P_1 + P_2 + P_3$$

Ku:

P_{of}- pikët që përfiton ofertuesi

O_{of}- oferta e ofertuesit

O_{max} - oferta që ka fituar pikët maksimale

P_k- pikët për kriter që do të përcaktohen në urdhër të ministrit rast pas rasti

P_t- pikët totale

P₁, P₂- Pikët për kriterin e parë, të dytë e në vijim.

5. Në rastet kur infrastruktura e peshkimit (porti dhe markata) do të transferohet për menaxhim pranë njërive të vetëqeverisjes vendore ose te organizatat e peshkimit, me urdhër ministri ngrihet, një komision i cili do të shqyrtojë kërkesat e paraqitura, ku në përbërje të tij të jenë edhe anëtarë të drejtorisë përgjegjëse për programet në fushën e peshkimit.

6. Kriteret për vlerësimin e planit të menaxhimit të paraqitur nga OMP-ja ose njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:

a) Investimet e parashikuara

Vlera monetare e nevojshme për kryerjen e investimeve në port ose markatë gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes.

b) Plani për sigurinë e infrastrukturës

Masat e nevojshme me qëllim krijimin e një gjendje të sigurt për subjektet që ushtrojnë veprimtari në port dhe/ose në markatë.

c) Cilësia e shërbimit

Tërësia e masave të nevojshme me qëllim ofrimin e shërbimit bazë, në një periudhë të shkurtër kohore dhe me cilësi të lartë.

ç) Kostot operative

Tërësia e shpenzimeve të nevojshme, gjatë një periudhe 1 vjeçare, për menaxhimin e portit të peshkimit ose markatës në varësi të objektit që transferohet. Vlera që do të konsiderohet për efekt konkurrimi do të jetë vlera totale e shpenzimeve të nevojshme për gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes.

7. Në rast se në procedurën e konkurrimit paraqitet vetëm një konkures, komisioni që do të shqyrtojë dokumentacionin, do të propozojë transferimin e menaxhimit të infrastrukturës, vetëm në rast se plan menaxhimi është në përputhje me qëllimin e transferimit, që nënkupton shërbim të një cilësie të lartë dhe me kosto operative të ulët, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të marrëveshjes.

8. Në rastet kur në procedurën e konkurrimit të sipërcituar marrin pjesë më shumë se një konkures vlerësimi do të bëhet në zbatim të metodologjisë të vlerësimit të kriterëve të konkurrimit si më poshtë:

- Kërkesat do të vlerësohen në bazë të kriterëve dhe metodologjisë së vlerësimit dhe fitues do të konsiderohet ai konkures, që ka numër më të lartë të pikëve, në bazë të kriterëve të vlerësimit.

- Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave, i krijuar në zbatim të urdhrit të ministrit, sipas VKM-së nr. 347, datë 22.5.2019, do të vlerësojë kërkesat, duke u bazuar në:

a) kriteret e përcaktuara në pikën 24, të kreut V të VKM-së; dhe

b) pikët e shpallura në konkurrim, duke vlerësuar plan menaxhimin më të mirë me pikët maksimale të kriterit.

- Konkuresi tjetër do të përfitojë pikët, duke u bazuar në aplikimin e formulës së mëposhtme, për kriterin e parë të konkurrimit (investimi):

$$\text{Pof} = \frac{\text{O of}}{\text{O max}} \times \text{Pk}$$

Detajimi me pikë për kriterin e dytë të komunikimit (plani për sigurinë e infrastrukturës do të bëhet me urdhër ministri, në bazë të pikës 4 të kreut dhe pikës 7 të kreut IV, të VKM-së nr. 347, datë 22.5.2019 në varësi të objektit që do të transferohet në menaxhim.

Detajimi me pikë për kriterin e tretë të konkurrimit (cilësia e shërbimit) do të bëhet me urdhër ministri, në bazë të pikës 4 të kreut V dhe pikës 7 të kreut IV të VKM-së nr. 347, datë 22.5.2019 në varësi të objektit që do të transferohet në menaxhim.

Për të vlerësuar kriterin e katërt të konkurrimit (kostot operative), do të aplikohet formula e mëposhtme:

$$\text{Pof} = \frac{\text{O min}}{\text{O max}} \times \text{Pk}$$

Pas përcaktimit të pikëve të vlerësimit për secilin kriter bëhet përlllogaritja totale e pikëve si më poshtë:

$$P_t = P_1 + P_2 + P_3 + P_4$$

Ku:

Pof- pikët që përfiton ofertuesi

Oof- ofertë e ofertuesit

Omax - oferta që ka fituar pikët maksimale

Omin- oferta që ka fituar pikët maksimale

Pk- pikët për kriter që do të përcaktohen në urdhër të ministrit rast pas rasti

Pt- pikët totale

P1, P2- Pikët për kriterin e parë, të dytë e në vijim.

9. Kriteret e përcaktuara në pikën 24, të kreut V, të VKM-së nr. 347, datë 22.5.2019 do të vlerësohen me pikët e mëposhtme:

- investimet e parashikuara 25 pikë;
- plani për sigurinë e infrastrukturës 25 pikë;
- cilësia e shërbimit 25 pikë;
- kosto operative 25 pikë.

10. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtorja përgjegjëse për programet në fushën e peshkimit dhe Drejtorja e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi